

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	05.03.2024
REFERENC-Ë:	4231/23 - ZSP - 2024
PËR/ZA/TO:	„KORAL CORPORATION” Sh.p.k.; K. F.Kosovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z. Izedin BYTYQI, Zavëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zavëndësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën si dhe dokumentacionin shtesë, me Nr. të protokollit: 4231/23, nga „Koral Corporation” Sh.p.k. K. F.Kosovë dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

L.U.

Datë 05.03.2024


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitive ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e palës „ **Koral Corporation** ” Sh.p.k.; **F. Kosovë**, me Nr. Protok. 7231/23, datë, 26.07.2023, për **Leje Ujore**, për shkarkim të ujërave të ndotura nga Fabrikë e Përpunimit të mishit dhe përpunimit të pemëve dhe perimeve, pas trajtimit në impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, në pikën koordinative grumbulluese:(X=7 506 930.933;Y= 4 721 230.054 ), si në projekt, në ngastrën P-72514036-02545-0 ; sipas kushteve vijuese:

**Leja Ujore jepet me këto kushte si në vijim:**

1. Leja Ujore i referohet ekskluzivisht shkarkimit të ujërave të ndotura nga fabrika për përpunimin e mishit dhe përpunimit të pemëve dhe perimeve ;
2. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv për kompleksin e objekteve, nën kushtet vijuese:
  1. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;




2. Analiza e ngarkesave kualitative të ujërave industriale, atmosferik dhe sanitar, të shprehur përmes parametrave standard kualitativ ( temperature, Ph, SHBO<sub>5</sub>, SHKO, sasia e materive të suspenduara, bakteret e ngjashëm) të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
3. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues kualitativ të recipientit (temperatura, ph, SHBO<sub>5</sub>, SHKO, sasia materieve suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe specifikat e recipientit;
4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur, llumit dhe ato të shkarkimit duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
5. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit, të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe të njejëtat t'i kompensoj;
6. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit duke përfshirë edhe mjedisin pritës. Rezultatet e monitorimit të raportohen në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/ARPL, për çdo gjasht muaj;
7. Obligimi financiar sipas Udhëzimit Administrativ për "Strukturën e pagesave të ujit" në fuqi, lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura, do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas "U.A. 02/2022, për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor"
8. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujqore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujqore;
9. Për vazhdimin e sërishëm të Lejes Ujqore, bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujqore;

### **ARSYETIM**

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: Elaborati dhe dokumentacioni tekniko investiv për leje ujqore për shkarkime ujërave nga fabrika e përpunimit të produkteve të mishit dhe përpunimit të pemëve "Koral Corporation" sh.p.k. F. Kosovë; bashkangjitur ka edhe Certifikaten e pronësisë P- 72514036-02545-0.


- "Sole Kosova" ka poseduar pëlqim ujqor, me Nr: Protok 6057/22 –ZSP- 2022, datë 17.10.2022, si dhe pas kërkesës për ndryshim të emrit, ku nuk parashihet ndonjë ndryshim me emrin e ndryshuar, me të cilin pala e ka parashtruar kërkesën në emër të "Koral Corporation" sh.p.k. aplikacion për Leje ujqore për shkarkim, dhe i ka bashkangjitur "Elaboratin dhe Dokumentacion tekniko investiv- për Leje Ujqore për



shkarkimin e ujërave nga fabrika e përpunimit të produkteve të mishit dhe përpunimit të pemëve – perimeve “

- Vlerësimin e llojeve të sasive të ujërave të shkarkuara: Nga procesi teknologjik i pastrimit të lëndës së parë dhe sipërfaqeve manipuluese;
- Shkarkimin e ujërave nga administrata e punëtorëve;
- Ujërat e shkarkuara nga rreshjet atmosferike;
- Llogaritja e sipërfaqeve kulluese – analiza hidrologjike;
- Projektin e impiantit SBR 100+ Filtration;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit të kompanisë hartuese”Alpha Zero 1 Sh.p.k.
- Diplomë e Veton Liman Elshani, bechelor i ndertimtarisë;
- vendim për ndryshim të emrit nga “Sole Kosova“ në “Koral Corporation” nga ARBK, me nr protokoli 133, datë 06.03.2023 i cili e posedon edhe numrin e njëjët të certifikates së biznesit si më parë;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit dhe emrit tregëtar në “Koral Corporation” , me nr ( 810492629);
- Certifikata e pronësisë në emer të “Koral Corporation “ sh.p.k. si qirrambajtje 99 vite;
- Shikimit në vend nga zyrtar të ARPL-së, ku edhe është mbajtur procesverbali i nënshkruar nga Pala dhe Zyrtar të ARPL-së, me datë 01.02.2024;
- Pagesës së bërë me rastin e aplikimit për leje ujore, sipas shtojces 6 të “U.A. 03/2018 për procedurat për Leje Ujore” në vlerë prej 200 €, CD-në; Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, legjislacionit për ujëra në fuqi, shikimit në vend, me datë 01.02.2024, me ç’rat është konstatuar nga zyrtar të ARPL-së objekti –Impianti i Trajtitimit të Ujërave të Ndotura, se është i ndërtuar, ku me këtë rast nga zyrtar të ARPL-së janë marë pikat karakteristike gjeodezike, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 4231/23 –ZSP- 2024, Datë: 05.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës se Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës F.Kosovë
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izëdin BYTYQI